



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.62, datë 27.11.2025

“PËR KTHIMIN NË FOND BANESE TË DY OBJEKTEVE: ISH-KOPSHTI I FËMIJËVE NË LAGJEN HASAN SEITAJ DHE ISH-ZYRAT E VJETRA TË NDËRMARRJES PYJORE, PËR QËLLIME STREHIMI”.

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 27.11.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKM-së nr.458, date 03.07.2019 “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve prone shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti I shtetit”, VKM nr.902, date 21.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Çorovodë, të qarkut Berat,

VENDOSI:

1. Kthimin në fond banese kati i dytë i objektit, ish kopshti fëmijëve Lagjia “Hasan Seitaj” me nr.pasurie 6/68 (kati i dytë), për qëllime strehimi.
2. Kthimin në fond banese, objekti ish Zyrat e Vjetra Hambull, të Ndërmarrjes të Shërbimit Pyjor, transferuar Bashkisë Skrapar nga Ministria e Mjedisit me aktin e transferimit nr. 3497 prot, datë 27.04.2017, dhe nr 69 prot, datë 16:05.2017, për qëllime strehimi.

Vendimi u miratua me 9 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

